

# Martesa dhe kurorëzimi në Zvicër

Fletë informacioni për prindërit



A mendoni për të ardhmen e fëmijës suaj?  
Me kënd do ta ndërtoj fëmija juaj familjen?

- Këtu mund të gjeni informata rreth temës së martesës dhe bashkëshortësisë në Zvicër.

## Baza ligjore në Zvicër

Prindërit kanë parashikime të ndyshme, se si do të duket jeta e fëmijëve të tyre. Lidhur me këtë duhet patur parasysh ligjet të cilat vlejnë në Zvicër. Ato janë të formuluara si vijojnë:

- Çdo person ka të drejtë të vendosë për veten e tyre nëse, kur dhe me kënd do të martohet.
- Një martesë duhet të lidhet vetëm nga vullneti i lire, për ndryshe ajo deklarohet si e pa vlefshme.
- Askush nuk mund të detyrohet për të lidhur një martesë. Përndryshe dënimi mund të jetë deri në 5 vjet me heqje lirie.
- Martesat me të mitur nuk tolerohen, madje edhe në qoftë se ato martesat janë të lidhura jashtë vendit.
- Në një martesë të detyruar ose në një martesë me të mitur, bashkimi familjar nuk do të jetë i mundur.
- Si për grate ashtu edhe për burrat vlejnë të drejtat e njëjta në të gjitha fushat.
- Secila grua dhe secili burrë ka të të drejtë, të shkurorezohet.

«Gjëja kryesore djemtë tanë martohen njëherë nga dashuria.»

(Davide, 45, Sizili)

«Unë nuk jam kundër traditës. Por kundër kurorëzimit të detyruar.»

(Şehriban, 36, Turqia)

Të dashur prindër,

Më vjen shumë rëndë të shkruaj këtë letër pas një kohe aq të gjatë. Divorci (ndarja) jonë më sjell shumë dhimbje dhe më duhet të kaloj shumë net pa gjumë. Për mua është e qartë, që edhe ju mendoni çdo ditë për mua: ndoshta të zemëruar, të zhgënjyer dhe sigurisht të brengosur. Unë e di që ju dëshironi zgjidhjen më të mirë për mua dhe unë ju dua ju pa masë, mirëpo unë nuk mundem dhe nuk dua të martohem me një burrë që nuk e dua.

JU lutem mos u zemëroni me mua! Ju më keni shoqëruar gjatë fëmijërisë dhe rinisë time, tani më duhet të gjejë rrugën vetë. Kjo rrugë është ndoshta për ju e pakuptim, mirëpo një ditë do të krenoheni me mua, këtë ju premtoj unë. Uroj fort nga zemra, që njëherë të takohemi pa zemërim dhe me kënaqësi. Nëse do të kisha mundësi sërish të zgjidhja do të vendosja sërish për ju si prindërit e mi.

Me dashuri, vajza juaj

«Vajzat e mia zgjedhin vetë.  
Për mua kjo është e rëndësishme.»

# Këshilla

Për më shumë informata ose një bisedë lehtësuese, ju lutemi kontaktoni një nga pikat e mëposhtme të qendrave:

## Këshillimoret

- [www.zwangsheirat.ch](http://www.zwangsheirat.ch), Tel: 021 540 00 00  
[info@zwangsheirat.ch](mailto:info@zwangsheirat.ch)
- Basel-Stadt: GGG Ausländerberatung  
Tel: 061 206 92 22, [www.ggg-ab.ch](http://www.ggg-ab.ch)
- Baselland: Ausländerdienst / ald  
Tel: 061 827 99 00, [www.ald-bl.ch](http://www.ald-bl.ch)
- Beratungsstelle für binationale Paare und Familien  
Tel: 061 271 33 49, [www.binational-bs.ch](http://www.binational-bs.ch)
- Opferhilfe beider Basel, Tel: 061 205 09 10  
[www.opferhilfe-beiderbasel.ch](http://www.opferhilfe-beiderbasel.ch)

## Këshillimoret familjare

- Basel-Stadt: Familien- Paar- und Erziehungsberatung  
Tel: 061 686 68 68, [www.fabe.ch](http://www.fabe.ch)
- Baselland (rajoni i Baselit): adresat mund t'i gjeni në [www.fejb.ch](http://www.fejb.ch)

## Në raste urgjente

- Policia e urgjencës tel: 117, [www.polizei.ch](http://www.polizei.ch)